

Kohëzgjatja e studimeve

1. Për studentët që kanë filluar studimet duke filluar nga viti akademik 2016-2017 e në vazhdim (viti kur ka hyrë në fuqi ligji i ri i Arsimit të Lartë), kohëzgjatja e studimeve është e kufizuar, referuar nenit nr. 90 të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*”.
 - Kohëzgjatja maksimale e studimeve në një program studimi nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve që parashikon programi, pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studentit i ka pezulluar studimet.
2. Studentët e regjistruar në një program studimi para vitit akademik 2016-2017, vit i hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.80/2015, datë 22.07.2015 “*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*” dhe që nuk i kanë përfunduar studimet, afati maksimal i studimeve është dyfishi i afatit kohor normal të studimeve, duke filluar nga viti akademik 2019-2020. Në këtë afat kohor, nuk përfshihet periudha e ndërprerjes së studimeve.
3. Studenti, që nuk arrin të përfundojë studimet brenda kohëzgjatjes maksimale të programit, ka të drejtë të aplikojë për të rifilluar studimet, në të njëjtin program studimi ose në një program tjetër. Ai u nënshtrohet kritereve dhe procedurave të shpallura për regjistrimin në programin e studimit të institucionit pritës. Kreditet e grumbulluara nga studentit gjatë periudhës së mëparshme të studimeve mund të transferohen, me vendim të njësisë bazë të institucionit që pranon studentin, sipas kritereve të përcaktuara në rregulloren e saj.